



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Senati i Universitetit

Ref. nr. 3188/25

Pejë, 16.12.2025

Në bazë në nenin 8 të Ligjit Br. 03/L-212 të Punës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-037 mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, nenet 169, 170, 171, 172 dhe 173 të Statutit nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregullores me nr. 025, datë 6.1.2023, për procedurat vlerësuese dhe përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë dhe Rregullores me nr. 2863, datë 3.10.2023, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. 025, datë 6.1.2023, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.12.2025, vendosi të shpallë:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin/avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë (UHZ)

I. FAKULTETI I BIZNESIT

Riemërim/avancim:

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Osnovi menadžmenta; Liderstvo i Odlučivanje* (ESAC 04.0);
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Napredni Strateški Menadžment; Operacioni Menadžment* (ESAC 04.0);
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Osnovi IT; Upravljački Informacioni Sistemi* (ESAC 04.2);
4. Një mësimdhënës për lëndët: *Međunarodni Biznis; Osnovi Biznisa* (ESAC 04.0).

Emërim për herë të parë:

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Bazat e Biznesit, Menaxhimi i Stresit dhe Kohës* (ESAC 04.0);
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Ndërmarrësia, Menaxhimi i Shpërblimit* (ESAC 04.0);
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Menaxhimi i NVM-ve, Menaxhimi i Talenteve* (ESAC 04.0);
4. Një mësimdhënës për lëndët: *Ekonomia Monetare, Auditimi i Avancuar* (ESAC 04.3).

II. FAKULTETI JURIDIK

Emërim për herë të parë:

1. Një mësimdhënës për lëndët: *E Drejta e Procedurës Penale; E Drejta Procedurale Penale - Pjesa e Posaçme* (ESAC 10: 10.4);
2. Një mësimdhënës për lëndët: *E Drejta Administrative - Pjesa e Posaçme; E Drejta Procedurale Administrative* (ESAC 10: 10.5; 10.6).

III. FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELIERI DHE MJEDIS

Për riemërim/avancim:

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Industria e Turizmit dhe Menaxhimi i Cilësisë* (ESAC 04.4; 04.7);

Emërim për herë të parë:

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Sistemet e Rezervimit në Hotele (Bsc. Në Gjuhën Shqipe dhe në Gjuhën Boshnjake); Menaxhimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Destinacioneve Turistike (MSc)* (ESAC 04.4; 04.7);

IV. KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

- a) Kushtet e përgjithshme për emërimin e personelit akademik janë të përcaktuara sipas dispozitave të parapara me Ligjin Nr. 04/L037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit nr. 04-V-622, datë 30.5.2013 të Universitetit “Haxhi Zeka”, si dhe Rregulloren me nr. 025, datë 6.1.2023, për procedurat vlerësuese dhe përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren me nr. 2863, datë 3.10.2023.
- b) Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.
- c) Përparësi kanë kandidatët që njohin gjuhën angleze dhe që posedojnë certifikatë për TOEFL test, si dhe trajnime për metodat bashkëkohore të mësimdhënies.
- d) Kandidatët të cilët aplikojnë për emërim, riemërim/avancim në thirrjen akademike **Profesor asistent** (Prof. Ass. Dr), duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës në fushën përkatëse;
 2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve, të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku një (1) punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në platformat WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe SCOPUS, si autor i parë ose korrespondent;
 3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 4. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në procesin mësimor në arsimin e lartë;
 5. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies;
 6. Emërimi për titullin *Profesor asistent*, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.
- e) Kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim/avancim në thirrjen akademike **Profesor i asocuar** (Prof. Asoc. Dr), duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 1. Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës;
 2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare të indeksuara në platformat WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS, si autor i parë ose korrespondent nga të cilat së paku dy (2) të jenë nga thirrja e fundit dhe të ketë kaluar të paktën katër (4) vjet nga thirrja e Profesorit asistent.
 3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;

4. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse.
 5. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies;
 6. Emërimi për titullin *Profesor i asocuar*, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.
- f) Kandidatët të cilët aplikojnë për avancim në thirrjen akademike **Profesor i rregullt** (Prof. Dr.), duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - 2.1. Së paku një monografi, tekste mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në platformat WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS, si autor i parë ose korrespondent nga të cilat së paku dy (2) të jenë nga thirrja e fundit dhe të ketë kaluar të paktën katër (4) vjet nga thirrja e Profesorit të asocuar.
 - 2.2. Pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - 2.3. Përvojë në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe kërkime shkencore;
 - 2.4. Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
 - 2.5. Aftësi për udhëheqje akademike;
 - 2.6. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës. Kriteri për metorimin e temave të doktoratës zbatohet 3 vite pas themelimit të studimeve të doktoratës në njësinë akademike përkatëse;
 3. Botimet duhet të jenë nga fusha e ekspertizës së kandidatit, nga fusha relevante ose fusha që kandidati mbulon në procesin e mësimdhënies.
 4. Emërimi për titullin *Profesor i rregullt*, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhet për kohë të pacaktuar.

V. DOKUMENTET E NEVOJSHME PWR APLIKIM

V.1. Dokumentet e nevojshme për kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim/avancim:

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën në konkurs, më rastin e aplikimit duhet t'i sjellin këto dokumente:

- a) Formularin për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën/Ekstraktin e lindjes;
- d) Vendimin për thirrjen e fundit nga UHZ dhe kontratën valide të punës me UHZ;
- e) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UHZ-së dhe Rregulloren nr. 025, datë 6.1.2023, për procedurat vlerësuese dhe përzgjedhëse lidhur më emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren me nr. 2863, datë 3.10.2023; si dhe
- f) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë.

V.2. Dokumentet e nevojshme për kandidatët të cilët aplikojnë për emërim për herë të parë për thirrje akademike në UHZ:

Kandidatët të cilët aplikojnë për emërim për herë të parë për thirrje akademike, më rastin e aplikimit duhet t'i sjellin këto dokumente:

- a) Formularin për aplikimi;
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën/ekstraktin e lindjes dhe kopjen e letërnjoftimit;
- d) Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- e) Kopjen e noterizuar të diplomave të tri niveleve;
- f) Vendimin e nostrifikimit të diplomës nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës;
- g) Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuara nga institucioni përkatësi i punësimi për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës, si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit duhet i bashkëngjitet edhe pasqyra e Trustit;
- h) Dëshminë se nuk ka masë disiplinore, apo nuk është duke u zhvilluar procedurë disiplinore, në institucionin publik apo privat, më të cilin kandidati ka pasur apo ka marrëdhënie pune;
- i) Certifikata mbi dënimet penale origjinale, të lëshuar nga Gjykata, përmes secilës dëshmohej se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje. Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e lëshimit;
- j) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UHZ-së dhe Rregulloren nr. 025, datë 6.1.2023, për procedurat vlerësuese dhe përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullt në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren me nr. 2863, datë 3.10.2023, si dhe;
- k) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë.

VI. VENDIMI, PERIUDHA E ANKIMIT DHE E PËRMBYLLJES SË KONKURSTIT

1. Kandidatët e pakënaqur me publikimin e raporteve të komisioneve vlerësuese në Buletin ose vendimit të Senatit, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë sipas neneve 18 dhe 20 të Rregullores nr. 025, datë 6.1.2023, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren me nr. 2863, datë 3.10.2023.
2. Konkursi për emërim të stafit akademik, duhet të përmbyllet me vendim përkatës të Senatit të UHZ-së, për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.

VII. MËNYRA E APLIKIMIT

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për më shumë se një pozitë duhet të sjellin kopje fizike për aq pozita sa aplikojnë.
2. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve të nevojshme (të cilat kërkohen sipas Rregullores nr. 025, datë 6.1.2023, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren me nr. 2863, datë 3.10.2023 dhe përcaktimeve të konkursit) duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike pranë Zyrës për Protokoll dhe Arkiv në ndërtesën e Rektoratit të UHZ.
3. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.
4. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në ueb faqen zyrtare të UHZ: <http://www.unhz.eu>, përkatësisht nga data **17.12.2025 deri më datë 31.12.2025**.

Ju lutem shkarkoni [këtu](#) formularin për aplikim.